

Njoftim për përqendrim me të cilin Ndërmarrja për telekomunikime Telekom Serbia shoqëri aksionare, Beograd, Republika e Serbisë do të fitojë kontroll të veçantë mbi EKOMAKS SHPK VRNJAČKA BANJA, Republika e Serbisë.

(lënda nr. 08-188 /2025)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 208/24 dhe 16/25), më 29.12.2025 te Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim me të cilin Ndërmarrja për telekomunikime Telekom Srbija shoqëri aksionare, Beograd, me seli të regjistruar në rrugën “Takovska” nr. 2, Beograd, Republika e Serbisë do të fitojë kontroll të drejtpërdrejtë të veçantë mbi kapitalin themelor të EKOMAKS SHPK VRNJAČKA BANJA me seli të regjistruar në rrugën Zheleznička 64, 36217 Vrnici, Vrnjačka Banja, Republika e Serbisë.

-Ndërmarrja për telekomunikime Telekom Srbija shoqëri aksionare, Beograd, Republika e Serbisë është operator i shërbimeve dhe rrjeteve të komunikimeve elektronike, i regjistruar për telekomunikime kablllore dhe nga shërbimet që ofron veçohen shërbimet e telefonisë fikse dhe mobile, internetit dhe shërbimeve multimediale në territorin e Republikës së Serbisë.

Personat e lidhur të Ndërmarrjes për telekomunikime Telekom Srbija shoqëri aksionare, Beograd, Republika e Serbisë, sipas njoftimit në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, janë:

– Shoqëria për tregti dhe shërbime MTEL SHPK Shkup, me seli të regjistruar në rrugën “Maksim Gorki” 11/1-3, Shkup, Qendër, në Republikën e Maqedonisë së Veriut, e regjistruar për veprimtari telekomunikime me tela, përkatësisht për ofrimin e këtyre shërbimeve: rrjet publik radio–komunikues, qasje me brez të gjerë në internet, shërbime ndër-operatorësh, shërbime telefonike publikisht të disponueshme në rrjetin publik të komunikimeve mobile, ritransmetim të shërbimeve të programeve televizive, satelit.

– Person i lidhur i MTEL SHPK Shkup është **Shoqëria e telekomunikimeve MTELMOBILE SHPK Shkup**. Shoqëria e telekomunikimeve MTELMOBILE SHPK Shkup vepron në tregun e ofrimit të shërbimeve mobile të komunikimeve elektronike (shërbim pripejd) dhe nuk u ofron përdoruesve të vet përfundimtar shërbim mobil pospejd. Shoqëria e telekomunikimeve MTELMOBILE SHPK Shkup është operator virtual i rrjetit mobil (OVRRM) në tregun maqedonas të komunikimeve elektronike dhe siguron shërbime kombëtare, ndërkombëtare dhe roaming për thirrje zanore, SMS dhe internet.

– **Shoqëria tregtare dhe shërbimore TOTAL TV SHPK Shkup** (“TOTAL TV SHPK Shkup”), me seli në Bulevardin “Partizanski odredi” nr. 17, 1-001/Shkup – Qendër, Qendër, në Republikën e Maqedonisë së Veriut, e regjistruar për veprimtari – telekomunikime satelitore.

-EKOMAKS SHPK VRNJAČKA BANJA, Republika e Serbisë është operator i shërbimeve dhe rrjeteve të komunikimeve elektronike, i regjistruar, në momentin e dorëzimit të Njoftimit, për ofrimin e qasjes në internet dhe shërbimeve të internetit, si dhe shpërndarjes së përmbajtjes mediatike.

EKOMAKS SHPK VRNJAČKA BANJA, Republika e Serbisë nuk ka persona juridikë të lidhur në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, dhe as nuk ka realizuar të ardhura në atë territor.

Tregjet për të cilat i referohet përqendrimi:

Parashtruesi i njoftimit propozon që si treg relevant në përqendrimin konkret të jetë tregu me pakicë për ofrimin e shërbimeve të qasjes fikse me brez të gjerë në internet dhe tregu me pakicë për ofrimin e shërbimeve të shpërndarjes së përmbajtjes mediatike.

Në bazë të shqyrtimit paraprak Komisioni ka konstatuar se përqendrimi në fjalë mund të bjerë nën dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje mbetet i rezervuar.

Komisioni i fton palët e treta të interesuara që t'i dorëzojnë vërejtjet dhe mendimet e tyre për këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. “Shën Kirili dhe Metodi” nr. 54, Shkup ose me e-mail: kzk@kzk.gov.mk dhe duhet të arrijnë te Komisioni brenda 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

30.12.2025

Shkup